

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
Fakulteti i Filologjisë

Lënda: Qytetërim shqiptar

Lëndë obligative. Niveli bachelor.

Viti i II i studimeve. Semestri III

Numri i orëve në javë: 3 + 2

Vlera në kredi ECTS : 5

Koha/lokacioni: E enjte: 10:00 -12:15.
Salla nr. 88.

Mësimdhënësi i kursit: Prof. ass. dr. Haki Hysenaj

Detaje kontaktuese: Zyra nr. 84. Telefoni: 044-125-005.

E-mail: h_hysenaj@hotmail.com.

Konsultime me studentë: të mërkurën nga 10:00-12:00 dhe të enjten nga 12:15-13:00.

Qëllimet e kursit: Në lëndën “Qytetërim shqiptar” studentët do të përvetësojnë njohuri nga historia dhe qytetërimi shqiptar. Në pjesën e parë të kursit studentët do të njihen me historinë e shqiptarëve, gjenezën e tyre, gjenezën e gjuhës shqipe, teoritë për prejardhjen e shqipes e të shqiptarëve, për kontaktet me etnitë dhe gjuhët e tjera.

Në pjesën e dytë studentët do të njihen me kohën e mesjetës dhe rolin e shqiptarëve në këtë periudhë. Më pas gjatë këtij kursi studentët do të njihen edhe me lëvizjet demografike të arbërve dhe gjuhën e tyre.

Ndërkaq, në pjesën e fundit të kursit studentët do të marrin njohuri nga koha e Rilindjes Kombëtare, për figurat e shquara të kombit dhe ngjarjet e fundshekullit të XIX dhe ato të shekullit XX.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Me këtë kurs pretendohet që studentët të kompletojnë njohuritë e tyre për historinë dhe qytetërimin e popullit shqiptar.

Metodologjia e mësimit: Ligjërata, ushtrime, diskutime, punë në terren, punime seminari, prezantime.

Literatura bazë: Grup autorësh, Historia e popullit shqiptar, Prishtinë, 1996; Grup autorësh, Studime ilire II, Rilindja, Prishtinë, 1978; Grup autorësh, Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1965; Aleksandër Stipqeviç, Ilirët, Prishtinë, 1967; Noel Malcolm, Kosova, një histori e shkurtër, Prishtinë, 2001; Eqrem Çabej, Për gjenezën e gjuhës shqipe, “Rilindja”, Prishtinë, 1996; T. Dhomi, Fjalori i mitologjisë, Rilindja, Prishtinë, 1988.

Plani i detajuar i mësimit:

Java e parë:

1. Hyrje në lëndën: Qytetërim shqiptar
2. Gjenezë e shqiptarëve-përkatësia indoevropiane

Java e dytë:

1. Gjenezë e gjuhës shqipe
2. Teoritë për prejardhjen e gjuhës shqipe

Java e tretë:

1. Qytetërimi ilir, kultura, tradita
2. Ndërndikimet kulturore

Java e katërt:

1. Vendi i formimit të gjuhës shqipe
2. Etnonimi Arbër-Shqiptar

Java e pestë:

1. “Shtetet ilire-principatat”-raportet me “shtete” e tjera të kohës
2. Fiset ilire

Java e gjashtë:

1. Mitologjia iliro-shqiptare
2. Eposi i shqiptarëve

Java e shtatë:

Vlerësimi i parë intermediar

Java e tetë:

1. Vlerat juridike dhe kulturore të “Kanunit” të L. Dukagjinit
2. Epoka e Skënderbeut

Java e nëntë:

1. Besimi pagan i paraardhësve të shqiptarëve
2. Besimet e shqiptarëve të sotëm-histori dhe interferenca

Java e dhjetë:

1. Lojërat popullore, muzika
2. Kostumografia iliro-shqiptare

Java e njëmbëdhjetë:

1. Historia e shtetit shqiptar
2. Shtetësia e Kosovës

Java e dymbëdhjetë:

1. Historia e shkrimit dhe e ideve
2. Humanizmi, publicistika shqiptare, historia e shqipes standarde

Java e trembëdhjetë:

1. Letërsia shqipe
2. Artet e tjera-ndërndikimet (Lindje-Perëndim)

Java e katërbëdhjetë:

1. Historia e muzikës, kulturës dhe teatrit
2. Personalitete të njohura shqiptare

Java e pesëmbëdhjetë:

Vlerësimi dytë intermediar (parapërgatitje për provim)

Provimi mbahet me shkri dhe me gojë

